

Njoftim për aplikime për modifikim licence

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë si vijon:

- shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për modifikimin e licencës së saj, dhënë me vendimin e Bordit të 132, datë 02.07.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, duke ndryshuar numrin e paneleve dhe duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit;
- shoqëria “Power Energy” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për modifikimin e licencës së saj, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 15.08.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 25 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit;
- shoqëria “Sunny Side Energy” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për modifikimin e licencës së saj, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Në mbledhjen e datës 28.05.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së secilës prej shoqërive të mësipërme.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesat e mësipërme për modifikim, brenda 30 (dhjetë) ditëve (nga data 30.05.2026 deri më 29.06.2026) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.